



Arsimi dhe tregu i punës

Politika të mira arsimore për ekonomi të suksesshme

Pozitat e Fondacionit Friedrich Ebert me fakte, teza për një kornizë trajtimi për hartimin e një arsimi të orientuar kah ardhmëria dhe politika e tregut të punës në Kosovë

Arsimi është "lëndë e parë" më e rëndësishme e Kosovës

Një politike e arsimit e përqendruar kah e ardhmja nuk mund të mbetet një faktor i izoluar në politikë dhe duhet të shihet si një detyrë publike prioritare. Politika e arsimit duhet të përmbushë një mori aspektesh dhe detyrash dhe veçanërisht në vende të tilla si Kosova është një element kyç për zhvillimin e mëtejshëm të vendit në një shtet të mirëqenies sociale të bazuar në modelin evropian. Prandaj, është e rëndësishme që të përdoren të gjitha burimet e vendit sa më efektivisht të jetë e mundur.

Në masën e njejtë siç nga ekonomia kërkohen punëtorë të kualifikuar për të gjitha nivelet e tregut të punës, poashtu duhet të gjithë të rinjtë – varësisht prej talenteve dhe mundësive të tyre – të kenë mundësinë e integritit në një treg pune funksional dhe efektiv. Një prioritizim i njëanshëm i disa drejtimeve dhe niveleve të caktuara arsimore, si dhe një ofertë arsimore gjithnjë e më e orientuar drejt ekonomisë private dhe të orientuar në përfitim, shpion pashmangshmërisht dhe qartazi drejtë deficiteve të mëdha në tregun e punës. Pasojat janë nga njëra anë një papunësi shumë e lartë e të rinjve dhe pak shanse për një (ri) hyrje në tregun e punës për personat e moshuar të cilët kanë qenë të papunë, nga ana tjetër, një mungesë në rritje e fuqisë punëtore të kualifikuar – si në sektorët akademikë, poashtu edhe ata jo-akademikë të ekonomisë. Kësaj i shtohet edhe një hendek urbano-rural me rritje të vazhdueshme dhe me një tendencë migrimi të shtuar.

Kësaj mund t'i kundërvihet vetëm përmes një koncepti integral, i cili kombinon përmbajtjen dhe ofertat e arsimit me nevojat aktuale dhe të ardhshme të një zhvillimi ekonomik të orientuar strategjikisht. Për këtë nevojitet një definim i ri i politikës së tregut të punës si një urë mes arsimit dhe ekonomisë, e cila në mënyrë proaktive përmes këshillimit kompetent profesional dhe me programe trajnimi të caktuara siguron që ofertat për kualifikime të përshtaten me nevojat e një ekonomie moderne.

Përdorimi i potencialeve ekonomike vetanake

Kosova ka një numër burimesh natyrore. Këto duhet së pari sa më shumë që është e mundur të përdoren dhe të ndërliken në mënyrë efektive. Këto burime përfshijnë:

- **Energjitë e rinovueshme** (uji, era, dielli): Këtu – varësisht nga rrethanat – ka shumë mundësi për gjenerimin e energjisë. Kjo do t'i mundësojë Kosovës – hap pas hapi – të çlirohet nga lëndët djegëse fosile të energjisë dhe të plotësojë nevojat e veta.
- **Bujqësia:** Bujqësia e Kosovës nuk e ka shfrytëzuar potencialin e saj akoma. Rendimenti mundet – me organizim të mençur dhe kompetent, mundësitë e magazinimit dhe përpunimin e mëtejshëm të certifikuar – të jetë dukshëm më i lartë dhe i orientuar drejt eksportit.
- **Turizmi:** Kosova ka një natyrë të larmishme në një hapësirë të vogël. Kjo pasuri mundet – me zhvillim ekologjik dhe të qëndrueshëm të turizmit – të çojë në të ardhura të qëndrueshme dhe në rritje.
- **Industria e lehtë:** Vendi ka disa tradita, p.sh. në sektorin e lëkurës dhe tekstilit. Përveç kësaj ka investime të reja që duhet të përdoren për zhvillim të mëtejshëm. Kështu, me investime të orientuara në cak, mund të krijohet një faktor ekonomik i suksesshëm dhe fitimprurës – gjithashtu dhe sidomos në sektorin e zejeve dhe me shumë biznese ekzistuese mikro dhe të vogla.
- **Minerale të vlefshme:** Depozitat ekzistuese përdoren vetëm në mënyrë të pamjaftueshme dhe me mjete të vjetëruara. Me investime të orientuara për modernizim dhe një lidhje me përpunimin e mëtejshëm mundësohen rendimente më të larta.

Koncepti i përgjithshëm për zhvillimin kosovar

Për të përdorur potencialin ekonomik në mënyrë efektive, investimet dhe projektet publike afatmesme dhe afatgjata duhet të përmbliken në një koncept të përgjithshëm. Ky koncept i përgjithshëm pastaj mund të formulohet si vizion "Kosova 2025". Elementet kryesore të këtij vizioni do të ishin:

- **Zhvillimi i infrastrukturës:** Zhvillimi i infrastrukturës së vendit është gjithashtu një masë e domosdoshme ndërsektoriale për zhvillimin e sektorëve ekonomikë. Ka të bëjë me furnizimin me energji, komunikimin, deponimin dhe asgjësimin e mbeturinave, me ujin e pijshëm dhe kanalizimin ose me trafikun.
- **Edukimi dhe arsimimi modern dhe i orientuar drejt profesionit:** arsimi nuk është një objekt i tregut të lirë. Shteti duhet të sigurojë një sistem arsimor modern dhe funksional që plotëson nevojat sociale dhe ekonomike.
- **Mirëqenia sociale:** si një shtet anëtar i BE-së, Kosova duhet të ketë standardet minimale të sigurimeve shoqërore dhe pensioneve. Këto përfshijnë, ndër të tjera, një ofertë funksionale për kujdesin për pleqtë dhe pacientët dhe një sistem shëndetësor funksional.

- **Shërbimet e orientuara drejt klientit dhe shërbimeve në sektorin publik dhe privat:** Një botë moderne e biznesit bazohet në funksionimin e shërbimeve publike të administratës. Përveç kësaj, shërbimet janë një sektor ndërsektorial që prek të gjitha fushat e ekonomisë dhe me kualifikimet e duhura kontribuon dukshëm në rritjen ekonomike.

Strategjia për veprim të koordinuar

Së bashku me të gjitha departamentet dhe gjithashtu akterët udhëheqës të sektorit privat të ekonomisë, detyrat e ndryshme të një koncepti të përgjithshëm publik për zhvillimin e Kosovës duhet të përshkruhen përmes një "road map" (udhërrëfyes), e cila do të përmbante një renditje realiste të hapave drejt realizimit dhe kontrollimit të zhvillimit.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve të tjera të zbatueshme, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës aktualisht regjistron format ligjore të mëposhtme të shoqërive tregtare: biznes individual, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare, degët e kompanive të huaja dhe kooperativat bujqësore.

- **Koordinimi i zhvillimit:** Asnjë nga këto fusha të orientuara drejt së ardhmes nuk mund të zhvillohet e pavarur nga të tjerat – modernizimi dhe zhvillimi i tyre varen reciprokisht.
- **Ekspertët e jashtëm si partnerë:** Për realizimin e këtyre qëllimeve prej fillimit duhet të përfshihen partnerët e bashkëpunimit ndërkombëtar me përvojat e tyre specifike në shtetet në transformacion.
- **Përdorimi i të gjitha burimeve financiare ekzistuese:** Përveç kësaj, duhet shpejtë të zgjerohen kapacitetet institucionale dhe aftësitë individuale teknike dhe menaxheriale për të qenë në gjendje të shfrytëzohen plotësisht dhe në mënyrë kompetente të gjitha fondet e BE-së në dispozicion.

Bashkëpunim i ngushtë ndërmjet sektorit shtetëror dhe atij privat

Në një ekonomi moderne, ekziston një nevojë për bashkëpunim kuptimplotë midis shtetit dhe akterëve ekonomikë. Sektori privat mban një masë të madhe të përgjegjësisë për zhvillimin e një vendi. Prandaj, duhet të integrohet më mënyrë të përshtatshme kudo ku vetëm një bashkëpunim mund të sjellë përparim. Kjo është në interes të përbashkët.

- Një fushë thelbësore e **bashkëpunimit** të nevojshëm është kualifikimi profesional – nga arsimit bazë drejt arsimit të mëtutjeshëm dhe masave të arsimit të vazhdueshëm.
- **Shteti duhet të vendosë kushtet e duhura**, për shembull në sistemin arsimor, ndërsa **ekonomia duhet të jetë përgjegjëse për përmbajtjen dhe lidhjen praktike me botën e punës**.
- Kësaj duhet t'i shtohet një **politikë aktive e tregut** të punës që nëpërmjet këshillave dhe mbështetjes së mirë (si ndërmjetësimi i ofertave për kualifikim) lidh nevojat e ekonomisë me qëllimet e atyre që kërkojnë arsim në mënyrë kuptimplote dhe efektive.

Përshkrimi i profesioneve dhe profileve të punës

Burimet njerëzore: Popullsia e punës në Kosovë është shumë e re. Në përgjithësi, megjithatë, ekziston një mungesë e kualifikimeve specialiste në të gjitha nivelet e ekonomisë. Me një trajnim të mirë dhe specifik, fushat e përmendura mund të përmirësohen dhe të zgjerohen në mënyrë të përshtatshme. Kjo do të sigurojë angazhim të qëndrueshëm në marrëdhënie të rregullta të punës. Një hap i mundshëm i një bashkëpunimi të nevojshëm midis shtetit, arsimit dhe biznesit për të zhvilluar një ofertë të mirë të punëtorëve të kualifikuar në sektorin akademik dhe jo-akademik do të ishte:

- **Profesionet kryesore:** Identifikimi i përbashkët dhe definimi modern i profesioneve më të rëndësishme dhe më të nevojshme të profesioneve kryesore në sektorët e ardhshëm të ekonomisë së Kosovës.
- **Kurrikulat e orientuara drejt praktikës:** Zhvillimi i përbashkët i përmbajtjes së arsimit profesional dhe kurrikulave për kualifikimin profesional të integruar shkollor dhe praktik.
- **Verifikimi:** Monitorimi i përbashkët – p.sh. në mbajtjen e provimeve – i aplikimit të standardeve dhe përmbajtjeve e dakorduara.
- **Certifikimi:** krijimi i përbashkët i një potenciali të kualifikuar specialist me kualifikime përgjithësisht të pranueshme që mund të përmbushin gjithashtu standardet ndërkombëtare.

Kurrikula sipas parimit dual për të gjitha nivelet profesionale

Një arsim profesional i orientuar kah e ardhmja duhet të ketë si parim bashkëpunimin më të fortë ndërmjet shkollave profesionale dhe kompanive. Të rinjve duhet t'u jepet mundësia për të njohur botën e punës edhe gjatë arsimimit të tyre profesional dhe kështu të përgatiten më mirë për tregun e punës. Në përgjithësi është e nevojshme që arsimi profesional, arsimi i mëtejshëm dhe arsimi shtesë të orientohen në praktikë si dhe të integrohen më mirë praktika dhe teoria. Kështu, merren parasysh në njërin anë kërkesat aktuale të tregut të punës dhe në anën tjetër vendosen themelet që punonjësit që të jenë në gjendje të kualifikohen më tej. Për të përcaktuar kërkesat përkatëse dhe profilet e arsimit profesional, një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet arsimit profesional dhe biznesit është i pashmangshëm:

- **Kërkesat praktike:** Ekonomia mund të vlerësojë më së miri se cilat kualifikime janë parakushte qenësore për atë aktivitet profesional.
- **Integrimi:** Kjo vlen si për përmbajtjen teorike poashtu për edhe përmbajtjen praktike të arsimimit. Dhe kjo duhet të vlejë për kualifikimet e shkathtësive të ulëta, të mesme dhe të larta.
- **Sistemi i graduar:** Prandaj duhet paraparë periudha të arsimimit të renditura dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën (për shembull, ½ për kualifikimet bazë, një tjetër 1 – 1 ½ vite për kualifikime të mesme etj.) që përfundojnë me certifikata të njohura.
- **Niveli ndërkombëtar:** Element përcaktues i shumë profileve të arsimit profesional duhet të jenë gjithashtu kërkesat ndërkombëtare për shumë kualifikime profesionale (siç janë aftësitë për të përmbushur standardet e kërkuara ndërkombëtarisht etj)

Sistemi Gjithëpërfshirës i Qendrave Multi-funksionale (MFZ)

Ofrimi i trajnimeve profesionale në Kosovë nuk është i shtrirë në tërë vendin. Veçanërisht zonat rurale janë larg ofrimit të perspektivave të mira sidomos për të rinjtë. Në planin afatgjatë, një sistem i trajnimit profesional në Kosovë duhet të ofrojë një zgjidhje të mirë për problemet kryesore:

- **Qendrat Multi-funksionale:** Me ofertën e tyre gjithëpërfshirëse në nivelet e ndryshme të kualifikimit profesional ato ofrojnë mundësinë më të mirë për një përmirësim të shpejtë të ofertës
- **Mundësi për të gjithë:** Të gjithë të rinjëve që dëshirojnë një vend pune duhet t'u jepet mundësia për të marrë një kualifikim. Edhe në zonat e largëta duhet të ofrohet së paku një arsim bazë mbi të cilin mund të ndërtohet. Një shkollim i mirë i orientuar drejt një profesioni nuk duhet të jetë çështje e burimeve financiare të nxënësve dhe prindërve. Për të rinjtë që janë të gatshëm të mësojnë, duhet të ofrohen konvikte etj, sidomos aty ku nuk ka oferta.

- **Kualifikimet e shpejta:** Për rinovimin e nevojshëm të ekonomisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj, punëtorët e kualifikuar duhet të jenë në dispozicion sa më shpejt në sektorët e orientuar drejt së ardhmes. Për këtë arsye, në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë që aktualisht kërkojnë specialistë duhet të konsiderohen masat afatshkurtra të kualifikimit në qendrat e përshtatshme multifunksionale të arsimit dhe aftësimit profesional.

Udhëzimi profesional si një element i politikës aktive të tregut të punës

Sondazhe përfaqësuese tregojnë se në Kosovë, sidomos të rinjtë – dhe prindërit e tyre – kanë pak informacion rreth asaj se cilat rrugë të karrierës mund të jenë premtuese dhe kuptimplote për ta. Informacioni mbi nevojat e ekonomisë është pothuajse i panjohur dhe deri më tani vështirë se komunikohet publikisht. Për këtë arsye, bashkëpunimi i ngushtë midis sektorit privat dhe politikës shtetërore të tregut të punës – si interes i përbashkët – do të jetë i nevojshëm edhe në të ardhmen. Për të korrigjuar defektet, në afatin e shkurtër mund të përfytyrohen masat e mëposhtme:

- **Shkëmbim i gjerë dhe i përditësuar i informacionit** ndërmjet sektorit privat dhe qendrave publike të punësimit në lidhje me nevojat aktuale dhe ato të ardhshme.
- **Qendra ose evente informative të zyrave të punësimit** ose zyrave të tyre vartëse për prindërit dhe nxënësit që tashmë janë në shkollat e mesme, në mënyrë që ata të kenë ndihmën e duhur në vendimmarrje për planifikimin e mëtejshëm të jetës së të rinjve.
- **Sistem këshillimor për studentët fillestar** lidhur me përzgjedhjen e tyre të drejtimit në bashkëpunim të ngushtë me universitetet dhe sektorin privat.
- **Integrim kuptimplotë i praktikave** në programet e studimit me qëllim korrigjimi ose përcaktimi të vendimeve të studimit, nëse është e nevojshme.
- **Këshillim për të papunësuarit** për një ri-trajnim të duhur ose trajnim të mëtejshëm për të rritur ose lehtësuar mundësitë e tyre të punësimit.

Orientimi i të gjithë sistemit arsimor për rritjen e ardhshme ekonomike

Politika e deritanishme e arsimit dhe trajnimit nga kopshti deri në universitet ka vuajtur nga probleme të ndryshme. Këto probleme janë gjithashtu përgjegjëse për një dështim të arsimit dhe trajnimit sa i përket shfrytëzimit të tyre profesional. Zgjidhjet më të rëndësishme janë:

- **Reduktimi i hendekut mes zonave urbane dhe rurale:** Sigurimi i arsimit dhe trajnimit për zonat rurale ka rënë në një masë të madhe, duke çuar në rritje të mjerimit për ekonominë lokale. Shumë familje zhvendosen në qytete ose edhe në shtete të tjera, sepse duan t'u ofrojnë fëmijëve mundësi më të mira për arsimim dhe karrierë. Ky trend duhet të ndalet, sepse nga njëra anë, qytetet vështirë se mund të ofrojnë mundësitë që migrantët e brendshëm presin dhe nga ana tjetër, zonat rurale duhet të lidhen më shumë me zhvillimin ekonomik.
- **Cilësi në vend të sasisë:** Në favor të një rritjeje të shpejtë të mundësive për arsim dhe trajnim – sidomos në arsimin privat – shpesh është hequr dorë nga standardet e mjaftueshme të cilësisë ose kërkesat e cilësisë iu nënshtrohen vetëm në shqyrtimi të pamjaftueshëm. Institucioneve ekzistuese arsimore tani duhet t'u nënshtrohen kontrollove të nevojshme të cilësisë. Nëse plotësojnë kërkesat, ato duhet të certifikohen me përcaktimin e një rishikimi të rregullt të përputhshmërisë me standardet.
- **Zhvillimi simetrik i programeve akademike dhe jo-akademike të studimit:** Me një fiksime të gjerë në një rritje të shpejtë të numrit të vendeve të studimit, është thelluar përshtypja tek popullata që studimet janë pothuajse të pashmangshme për një karrierë profesionale. Kjo po shkakton një numër të madh vendimesh të gabuara tek adoleshentët dhe prindërit e tyre, gjë që ka çuar në një nivel të lartë zhgënjimi dhe frustrimi – rrjedhimisht edhe tek ekonomia.
- Në të ardhmen, duhet të ketë një lidhje më të mirë të përmbajtjes së punës me arsimin fillor dhe të mesëm – veçanërisht nëpërmjet përvojave të punës praktike.
- Përveç kësaj, duhet të ketë një politikë aktuale të informacionit mbi perspektivat e karrierës në të gjitha nivelet.
- **Zgjerimi i ofertës së arsimit publik së bashku me programet akademike:** Duke pasur parasysh fokusin e qartë në arsimin akademik, alternativat ekzistuese në fushën jo akademike nuk u promovuan në mënyrë adekuate dhe zor se u zhvilluan në një alternativë reale. Kjo duhet të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur. Paralelisht edhe fushata ndërgjegjësuere publike janë të nevojshme.
- **Mesimnxënia e orientuar në proces:** Duke pasur parasysh ndryshimet e shpejta në jetën e punës dhe rritjen eksplozive të informacionit, nuk është më i mjaftueshëm fiksimi në mësimin e fakteve. Përkundrazi, përmbajtja edukative duhet të ketë si cak zhvillimin e aftësive për të njohur dhe formësuar proceset dhe për të qenë në gjendje të përballohen kërkesat e ardhshme.
- **Mësimi dhe puna në ekip:** Duke pasur parasysh kërkesat gjithnjë e më komplekse të botës moderne të punës, orientimi i ekipit dhe puna ekipore janë një kualifikim i domosdoshëm për punonjësit e ardhshëm. Këto objektiva duhet të zëvendësojnë menjëherë arsimin që synon konkurrencën dhe izolimin.
- **Marrja e përgjegjësisë dhe riskut** duhet të bëhen pjesë e arsimit të integruar në shkollat profesionale, shkollat e mesme dhe universitetet. Sidomos në Kosovë, duke pasur parasysh dendësinë e madhe të ndërmarrjeve të vogla, mësimi sipërmarrës (entrepreneurial learning & culture) paraqet një bazament të rëndësishëm dhe të domosdoshëm të arsimit shkollor dhe mbi të gjitha të arsimimit profesional.



www.fes-prishtina.org

Printed in Prishtina, 2017.